



ERZBISTUM
HAMBURG

Fjalimi i baritor i kryeipeshkvit të Hamburgut, Msgr. Stefan Heße

me rastin e kremtimit
të festës së Shën Ansgar-it,
pajtor i Kryeipeshkvisë,
më 03 shkurt 2021



Fjalimi i baritor i kryeipeshkvit të Hamburgut, Msgr. Stefan Heße

me rastin e kremtimit të festës
së Shën Ansgar-it, pajtor i Kryeipeshkvisë,
më 03 shkurt 2021

Të dashura motra dhe vëllezër!

Tash një vit virusi korona e ka ndryshuar shumë jetën tonë. Nuk bëhet fjalë për një zgjidhje të problemit, aq më pak të ndonjë problemi të vogël. Po përjetojmë – sigurisht pa ekzagjeruar – një prerje të qartë në historinë e njerëzimit. Megjithëse përvojat tona konkrete ndryshojnë shumë, kjo ka të bëjë me ndryshim themelor. Uroj që ta mbijetojmë mirë pandeminë dhe të marrim një mësim të mirë nga kjo!

Fillimisht pandemia e virusit korona thjesht më qiti nga takti dhe, në fakt, më ngadalësoi në shumëçka. Shumë gjëra nuk mund të bëhen më. Takimet nëpër famulli, vizitat, bisedimet, festimet, përvjetorët, shtegtimet – tani nuk mund të zhvillohen. Janë anuluar gjithashtu edhe shumë mbledhje. Shërbimet e mia ipeshkvore i kryej thuajse tërësisht brenda apo nga kuria ipeshkvore e Hamburgut, shpesh në mënyrë digjitale.

Megjithatë, e njoh gjithashtu edhe përvojën e të tjerëve, pikërisht të familjeve dhe profesionistëve, veçanërisht atyre të vetmuarve, dyfish dhe trefish të sfiduar. Mendoj në të gjithë ata që po angazhohen deri në pikën e fundit në shëndetësi. Korona të rraskapit dhe ne po e përjetojmë atë si një vrapim në distanca të gjata.

Si po e përjetojmë tani konkretisht këtë kohë, e cila po na qet para sfidave ekzistenciale. Sfidat po na thërrasin në kuptimin e plotë të fjalës, të dalim nga

e gjertanishmja dhe po na shpien në diçka të re, të cilën nuk e njohim akoma si dihet. Këtë po e përjetojnë të gjithë ata që vërtet po përballem me çështjet e ekzistencës së tyre, sepse nuk mund ta kryejnë punën e tyre – qoftë si të pavarur ose në një ndërmarrje – dhe nuk dinë me çfarë të jetojnë dhe se a do të mbijetojë krizën ndërmarrja e tyre. Të tjerët tashmë janë plotësisht të pa punë dhe pa të ardhura.

Por, fjalën ekzistencë dua ta kuptoj më thellësisht. Prapa kësaj qëndrojnë për mua pyetjet, si: Nga çka dhe për çka jam duke jetuar? Çka më mban? Çfarë më jep kuptim dhe mbështetje në këtë moment? Kur qindra, madje mijëra njerëz në Gjermani dhe nëpër botë vdesin apo luftojnë çdo ditë rreth jetës së tyre apo rreth jetës së njerëzve të dashur, atëherë ne nuk mund t'i shmangemi kësaj pyetje virulente.

Muajt e fundit më kanë sjellë më shumë në kontakt me rrënjët e mia, rrënjët e besimit tim dhe rrënjët e jetës sime. Rrënja më e thellë është dhe mbetet Zoti. Pikërisht tani më ra në dorë një lutje nga kardinali anglez, John Henry Newman (1801–1890), në të cilën lutet: “Zoti im dhe Shpëtimtari im, qëndro me mua! Larg teje do të venitem dhe do të thahem. Nëse do të të më shpallesh përseri, do të lulëzoj në një jetë të re. Unë nuk mund të të mbaj, vetëm mund të të lus: Zot qëndro me mua, sepse mbrëmja po vjen!”¹

Muajt e fundit më kanë dhënë më shumë mundësi t'i rishikoj këto rrënjë dhe të kujdesem për to. Përsiatja e përditshme nga Bibla, kremtimi i Meshës së shenjtë, lutja, veçanërisht rruzarja e thjeshtë, kanë shkëlqyer përsëri në mua. Është besimi i patundur, që nga Zoti i dashurisë të thirrsh personalisht përsëri në jetë. Ky Zot qëndron në anën tonë - edhe në sëmundje, edhe në çastin e vdekjes, edhe në vdekje. Ai dëshiron të na drejtojë në një jetë që tejkalon të gjitha pritshmëritë tona.

Nëse në një krizë si kjo aktuale ndiejmë se nuk e kemi jetën fort në kontroll, kur na bëhet e pamundur të planifikojmë gjithçka dhe deri në detajet e fundit, kur nuk mund të parashikojmë asgjë, si do të zhvillohet më tutje virusi, është e rëndësishme të ndërtojmë mbi baza të besueshme. Nëse nuk i kemi në dorë të gjitha këto, atëherë ne si të krishterë jemi në duart e mira të Zotit.

Besimtarë të dashur!

Koha e koronës ma bëri të qartë se vërtet jeta ime më parë paska qenë e stërmbushur. U përpoqa të shtrydhja formalisht kohën nga mëngjesi deri në mbrëmje. Më duket si një jetë në korsi të shpejtë. Besoj se një gjë e tillë nuk është e shëndetshme në planin afatgjatë. Korona ka frenuar fuqishëm jetën time. Por qysh tani e shoh rrezikun për të përshpejtuar përsëri me të gjitha forcat e mia. Po kërkoj një mënyrë për të jetuar më me vetëdije dhe më ngadalë.

Papa Françesku ka theksuar në disa raste se ne, në një botë të sëmurë, nuk mund të shërohemi. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me shëndetin tonë personal, por me një botë të shëndetshme dhe me një njerëzim të shëndosh. Pikërisht politika dhe ekonomia janë të thirrur të japin kontributin e tyre në shërimin e të gjithëve. Çdo i krishterë apo e krishterë mund të bashkëpunojë në këtë drejtim. Kjo është arsyeja pse është e domosdoshme, si i/e krishterë të kyçesh

në jetën publike. Në këtë sfond, për shembull, e shoh punën time për refugjatë, veçanërisht në këtë kohë. Pandemia i godet më së forti ata më të dobëtit!

Korona i përfshinë të gjithë; asnjë i vetëm nuk mund të përjashtohet nga ajo. Në këtë pikëpamje tani të gjithë e ndiejmë varfërinë tonë. Jam i sigurt, se zgjidhjet dhe mënyrat vendimtare në të ardhmen do t'i gjejmë vetëm nëse i kërkojmë së bashku. Këtu bëhet e qartë ajo që ne të krishterët besojmë: Askush nuk shpëtohet vetëm. Në enciklikën e tij "Spe salvi" (në shpresë të shpëtuar), Papa Benedikti XVI, në vitin 2007 shkruan: "Ekzistenca jona është e ndërthurur dhe e lidhur me njëri-tjetrin përmes ndërveprimeve të ndryshme. Askush nuk jeton vetëm. Askush nuk mëkaton vetëm. Askush nuk shpëtohet vetëm. Jeta e të tjerëve përherë arrin në jetën time: në atë që unë mendoj, flas, bëj, punoj. Në të kundërt, jeta ime shtrihet në atë të të tjerëve ... Shpresa jonë është gjithmonë shpresë thelbësore edhe për të tjerët dhe vetëm atëherë është vërtet shpresë për veten time. Si të krishterë, ne kurrë nuk duhet vetëm ta pyesim veten: Si mund ta shpëtoj veten time? Por gjithashtu: Si mund të shërbej që të tjerët të shpëtohen dhe që ylli i shpresës të ndriçojë për të tjerët? Kështu kam punuar më së shumti për shpëtimin tim personal." (nr. 48)

Korona më ka treguar apo ende më tregon, se: gjëja më e rëndësishme në jetë janë marrëdhëniet. Jeta është më e bukur aty ku është e pasur me marrëdhënie. Kjo është arsyeja pse korona na lëndon kaq shumë, sepse tani duhet të heqim dorë nga shumë marrëdhënie, kontakte dhe takime të drejtpërdrejta. Format e reja që mediat digjitale po na ofrojnë, kurrë nuk mund t'i zëvendësojnë takimet personale, edhe pse janë një alternativë e mirë. Secili prej nesh përmalohet për një kontakt ndër-njerëzor me një shtrëngim dore, një vështrim të hapur sy më sy apo një përqaftim. Pikërisht për Krishtlindje kjo na ka munguar dhimbshëm. Njeriu nuk është thjesht vetëm një trup. Është trup dhe marrëdhëniet ndër-njerëzore e bartin jetën tonë. Shi në faqet e para të Biblës thuhet qartë

dhe thjesht: “Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm.” (Zan 2, 18). Ndoshta kjo distancë fizike dhe shoqërore do të ndikojë në ne më shumë se çdo gjë tjetër.

Shpresojmë, se kur jeta jonë të relaksohet, prapë në të ardhmen do t’i vendosim marrëdhëniet ndërnjerëzore në radhë të parë. “Kë nuk e kam parë prej kohësh?”, “Kush pret një shenjë të re afërsie prej meje?” Por, le të mos mbingarkohemi në këto marrëdhënie. Ta falim njëri-tjetrit për ato që i detyrohemi në mënyrë të ndërsjellë. T’ia japim njëri-tjetrit hapësirën që i nevojitet secilit individ.

Edhe famullitë tona do të varen shumë nga mënyra se si do të ribashkohemi sërish në meshtë tona, para së gjithash në meshën e së dielës. Kremtimi eukaristik i së dielës, si kremtim i vdekjes dhe i ringjalljes së Jezu Krishtit, është kryekëput bashkim i Kishës dhe i çdo famullie! Si një Kishë në diasporë, ne do të shkojmë në kërkim të çdo “deleje” dhe do të detyrohemi të ndërtojmë shumë gjëra të reja. Kjo sigurisht që përmban shumë mundësi të reja. Unë jam shumë i lumtur për angazhimin dhe krijimtarinë e larmishme, me të cilën shumë motra dhe vëllezër në famullitë tona, tashmë po e bëjnë më të mirën në rrethana që gjendemi dhe njëkohësisht po fitojnë përvojë të vlefshme pozitive kishtarë.

Papa Françesku shpalli vitin 2021 vit të familjes. Familja është bashkësia më e rëndësishme dhe e para, në të cilën hyjmë dhe që ka një ndikim të vazhdueshëm në jetën tonë. Kjo është pikërisht ajo që na duhet tani të gjithëve: një ndjenjë e fortë e bashkimit, që qëndrojmë pranë njëri-tjetrit, veçanërisht në anën e të dobëtve. Aty, ku e bëjmë saktësisht këtë, pyetja e rëndësishme së Kishës nuk shtrohet fare, sepse aty Kisha është kompetente, sepse bën diçka, që është me rëndësi jetike për njerëzit.

Të dashur besimtarë!

Ta vendosim besimin tonë kundër frikës, shpresën kundër shqetësimeve, afërsinë kundër distancës, dashurinë kundër çdo indiference. Le të besojmë kundër çdo pesimizmi në shoqërimin e Zotit gjatë udhëtimit tonë dhe të shqetësimit që Ai ka për ne! Le të mos e lejojmë veten të largohemi nga njëri-tjetri, e aq më tepër të ngrihem kundër njëri-tjetrit, por le të punojmë së bashku në ndërtimin e një bashkimi të të gjithë njerëzimit.

Zoti ju bekoftë dhe ju ruajt Ju dhe të gjithë ata, me të cilët jeni të lidhur!

Me bekimet dhe urimet më të mira,

kryeipeshkvi Juaj,



+ Stefan

¹ Teksti i plotë është:

“Zoti im dhe Shpëtimtari im, qëndro me mua! Larg teje do të venitem dhe do të tahem. Nëse do të të më shpallësh përseri, do të lulëzoj në një jetë të re. Unë nuk mund të të mbaj, vetëm mund të të lus: Zot qëndro me mua, sepse mbrëmja po vjen! Qëndro me mua, derisa vdekja të më nxjerrë nga kjo luginë e errët e tokës. Po Jezus, qëndro me mua përgjithmonë! Nëse natyra ime e dobët do të fundoset, bëj që hiri yt të rrjedhë edhe më më bollëk. Ti je drita, që kurrë nuk shuhet; flaka, që flakëron gjithmonë – qëndro, dhe i ndriçuar nga shkëlqimi i dritave tuaja, unë vetë do të bëhem dritë, për të ndriçuar për të tjerët. Por, kjo dritë vjen tërësisht nga ti, asnjë rreze nga unë. Unë jam tamam si gota, përmes së cilës ti ndriçon të tjerët. Ndiriçoji me dritën tënde, ashtu si më ndriçove mua. Bëj ta shpalli lavdinë tënde, të vërtetën tënde dhe vullnetin tend. Jo përmes fjalëve tingëlluese, por përmes fuqisë së heshtur të dashurisë aktive në rrugën time të jetës, përmes dashurisë së sinqertë të zemrës sime, që po ta dhuroj ty.”



ERZBISTUM
HAMBURG

Erzbistum Hamburg
Am Mariendom 4
20099 Hamburg
www.erzbistum-hamburg.de